



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:235929

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05608196

AC-I-23-0395

Në ankesën e

Paditësi

M I nga fshati Gj, Komuna e Vitisë.

kundër

E paditura/Ankuesja

NSH. NBI "Agromorava", (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6580 të datës 12 qershor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6580 i datës 12 qershor 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 20 tetor 2014, paditësi përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI035-0174 të datës 03 tetor 2014, me të cilën kërkesa e paditësit e datës 26 gusht 2014 për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 1.500,00 euro është refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi e kundërshton vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke e konsideruar se konstatimi se kërkesa është parashkruar është i pa bazuar, pasi që ai pohon se ka punuar deri me datën 25 nëntor 2005 kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës me të cilin rast është bërë largimi kolektiv nga puna. Paditësi pretendon se pa ndonjë bazë ligjore i është refuzuar kërkesa nga ana e Autoritetit të Likuidimit.

Ankuesi ka dorëzuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 22 shtator 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të tregojë se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa për paga për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që paditësi ka dështuar të sjell prova për të dëshmuar se pagat i ka kërkuar tek Gjykata kompetente brenda 3 viteve. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 15 mars 2023, paditësi ka dorëzuar në DHPGJS një parashtresë me të cilën ka dorëzuar njoftimin e AKM-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 25.11.2005 dhe kopjen e Librezës së punës.

Me datë 12 qershor 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-6580, e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe e obligon të paditurën që ti paguaj paditësit shumën prej 1.500,00 euro në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të

Kontratës së punës sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në NSH deri në ditën e privatizimit me 25 nëntor 2005, kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës. E paditura pretendon se kërkesa për këto paga është e parashkruar, ndërsa paditësi e konteston këtë qëndrim të AKP-së, ndërsa bazën e kërkesës e mbështet në Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Tutje Shkalla e I-rë ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me paga të papaguara që NSH i ka mbetur borxh ankuesit, por kemi të bëjmë me dëmshpërblim të cilin vet Ligji i AKP u njuh punëtorëve, prandaj thirrja e AKP-së në nenin 608 është e pabazuar. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e datës 25 nëntor 2005 e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës dhe se bazuar në këtë njoftim kur ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH-së, paditësi e ka paraqitur me kohë kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së i është referuar edhe disa rasteve të mbyllura në jurisprudencën e Kolegjit të Apelit.

Me datë 30 qershor 2023, AKP-ja e ka dërguar me postë në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-14-6580 të datës 12 qershor 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. AKP-ja pohon se bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës konsiderohet e parashkruar pasi që paditësi nuk ka ofruar dëshmi të ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve në Gjykatën kompetente. Tutje AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të tregoj cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, ndërsa DHPGJS-ja sipas AKP-së ka juridiksion vetëm për të verifikuar ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 28 gusht 2023, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje paditësi pohon se me Aktgjykimin e ankimuar janë vlerësuar drejtë provat e

paraqitura andaj në mënyrë të drejtë është vërtetuar edhe gjendja faktike. Tutje paditësi pohon se në mënyrë të drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, prandaj nuk ka asnjë bazë ligjore të anulohet ose të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar. Në këtë parashtresë paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apeli vëren se paditësi me datë 26 gusht 2014, e ka paraqitur një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit dhe ka kërkuar kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës nga NSH "Agromorava" (në likuidim) në shumën prej 1.500,00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi pranë Shkallës së I-rë ka dorëzuar Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 25 nëntor 2005 dhe kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 25 nëntor 2005.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e ka aprovuar ankesën e paditësit dhe e ka ndryshuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke e detyruar të paditurën që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës ti paguaj paditësit shumën prej 1.500,00 euro, që do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së duke u bazuar në faktin se AKP-ja nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkuar të kompensimit, dhe duke u bazuar në Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, me të drejtë ja ka njohur paditësit të drejtën në kompensim, pasi me të drejtë ka konstatuar se kërkesa nuk është parashkruar.

Kolegji i Apelit në rastet e mbyllura në jurisprudencën e tij, shumë herë ka konstatuar se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në afatin e parashkrimit. Prandaj nuk mund të mbështetet konstatimi i gabuar i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, është parashkruar.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 26 korrik 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me 23 prill 2024.

Mr.sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
